



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1229 Prot.

Maliq, më 24.02.2021

NJOFTIM

LËNDA: Mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Maliq

DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ

KRYETARIT TË BASHKISË MALIQ

Të nderuar,

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” datë 17.12.2015, i ndryshuar, neni 53, “Funksionimi i këshillit bashkiak”, pika 2, pika 4, 5 neni 56 “Kryetari i këshillit bashkiak” pika 2 gërma “a”, dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq” ju njoftojmë se mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Maliq, do të zhvillohet elektronikisht, si pasojë e zbatimit të protokolleve të sigurisë mbi COVID-19, ditën e **mërkurë, më datë 03.03.2021, ora 10:00** me këtë,

Rend Dite:

1. Hapja e mbledhjes (korumi, vendimet e mbledhjes së kaluar, miratimi i rendit të ditës);
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 29.01.2021;
3. P-V “Për një ndryshim në fondin social”;
4. P-V “Për miratimin në parim të aplikantëve përfitues të subvencionit të qirasë, për vitin 2021 dhe dërgimin për financim të vlerës për subvencionin e qirasë”;
5. P-V “Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë”.
6. P-V “Për miratimin e bursave shtesë për arsimin e mesëm-profesional”;
7. P-V “Për miratimin në parim të dhënies në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullosor”;
8. P-V “Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.71, datë 30.09.2016 “Për miratimin e listave bujqësore të pandara me qëllim dhënien me qira të tyre, për NJA Pirg, Vreshtas dhe Pojan të Bashkisë Maliq”;
9. Informacion nga Ujësjellës-Kanalizime sh.a Maliq, lidhur me shqetësimet e Këshillit;
10. Informacion nga ekzekutivi për përballimin e situatës të krijuar si pasojë e motit të keq, menaxhimin i situatës dhe problemet e hasura;
11. Diskutime të tjera.

Ju faleminderit!

KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLLARI

